

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 8 SHTATOR 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Akti normativ nuk është gjë tjetër veçse ajo skemë që është atje: përkrah flamurit shqiptar të ngrihet edhe flamuri i Bashkimit European. Si imazh është shumë i bukur! Në fakt, ëndrra 32-vjeçare e të gjithë shqiptarëve është ta shikojnë Shqipërinë si e gjithë Europa. Ëndrra ngelet edhe sot ëndërr. Megjithatë, është një hap para. Sigurisht që nuk ka asgjë europiane, zonja Kryetare, kur i heq të drejtën një kolegu për të folur, sepse liria e shprehjes së deputetëve është thelbi i europianizmit. Në fakt, dje ka ndodhur edhe një ngjarje tjetër, të cilën duhet ta përmendim. Vendi ynë ishte pre i një sulmi kibernetik nga Irani, por më i rëndësishëm ishte fakti që vendit tonë iu ndodhën në krah Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania, pra Perëndimi.

Kjo është vlera reale, përtej imazhit të ngritjes së flamurit të BE-së krahas atij të Shqipërisë. Meqë jemi në një situatë të tillë, ku flitet për aspiratën e të gjithë shqiptarëve, pa asnjë dallim, u dëgjua edhe klima politike e moderuar. Duhet ta pranojmë edhe këtë, pra po largohemi nga brutaliteti banal dhe pretendojmë të jemi më të kultivuar në dialektikën politike, si europianët, nëse doni, edhe për një shtysë patriotike, jo hipokrite. Ndoshta është momenti që në situata të tilla të mendojmë dhe të veprojmë si europianët. Kjo është e rëndësishme. Në fakt, të shikojmë se çfarë përfaqëson flamuri i BE-së, dhe duhet ta shikojmë ashtu siç është realiteti, me shtetin e së drejtës, zgjedhjet e lira, zbatimin e ligjit, respektin ndaj qytetarëve dhe mirëqenien ndaj familjeve, është një gjë.

Ndërkohë, do të duhet të jemi gjithmonë nën psikozën për të folur me patriotizëm për këtë vend, për sa kohë që kemi aspiratën për të shkuar drejt Bashkimit European, për ta parë edhe në mënyrë të ftohtë situatën, se çfarë përfaqëson flamuri shqiptar krahas atij të BE-së;

kërkohet kurajë intelektuale dhe politike. Çfarë ka europiane sot tek ikja e shqiptarëve, ashtu si 32 vjet më parë?! Çfarë ka europiane sot, kur krimi është modeli i vetëm që i jepet shoqërisë dhe rinisë shqiptare?! Çfarë ka europiane sot, kur korrupsioni është buka e përditshme e shtetit në kurriz të shqiptarëve?! Çfarë ka europiane sot, kur çmimet veçse rriten, madje kur në Europën e atij flamuri blu ulen dhe këtu vetëm rriten?!

Çfarë ka europiane sot, kur vendi i shqiptonjave është shndërruar në lavatriçen e pastrimit të parave?! Çfarë ka europiane sot, kur legalizohet pastrimi i parave si shërbim ndaj krimit me amnistinë fiskale?! Çfarë ka europiane sot, kur droga, kanabisi ka mbuluar vendin? Çfarë ka europiane, kur krimi dhe oligarkia janë fuqizuar aq shumë sa e sfidojnë shtetin në mes të ditës?! Çfarë ka europiane, kur drejtori i policisë, figura kryesore, e cila duhet të luftojë problemin kryesor që ka vendi sot, krimin, shkarkohet pa motiv, pa transparencë, në një kohë shumë të shkurtër, dhe kur një ditë më pas ai del dhe tregon në Europë, në mes të Francës, që në Shqipërinë e flamurit tonë aksionet policore dekonspirohen?! Çfarë ka europiane në një vend, ku njëri prej jush, kur ishte ministër i Brendshëm, deklaronte për 4 familje mafioze, 40 banda?!

Çfarë ka europiane në këtë vend, ku u mor me tamtame të mëdha OFL-ja dhe rezultati ishte zero?! Çfarë ka europiane, kur kullat ngrihen në mes të Tiranës e kur Kryeministri i vendit, një ditë të bukur, sikur të mos ekzistonte dhe të mos kishte qenë në këtë vend, çuditet sepse gjysma e tyre janë pa leje?! Çfarë ka europiane në këtë vend, kur çështja më kryesore, ajo e korrupsionit, çështja e investimeve strategjike, që përfshin një ministër në këtë mes, mbyllet me sarkofag?! E pra, ky është realiteti, që kuraja politike, integriteti moral i të gjithëve ne duhet ta shohë ashtu siç është, pa filtra. Kjo është europiane; kjo është sjellja që na duhet për t'i dhënë dinjitet atij flamuri, që qëndron krahas flamurit të BE-së.

Meqë e thashë në fillim, që në momente të tilla, kur flitet për çështje kaq të rëndësishme, bashkë edhe me sensin patriotik që gjithsecili, si shqiptar, duhet ta ketë, për t'i dhënë dinjitet flamurit, absolutisht, ftesa jonë, si një thirrje e brendshme, duhet të jetë e tillë, që të gjithë së bashku të ndërmarrim akte civilizuese europiane. Përse sfidohet sot shteti nga krimi? Përse sfidohet sot shteti nga oligarkia? Për një arsye të thjeshtë, që të gjithë e dimë, se ka qenë filli përshkues që nga viti 2013 e këtej: lidhja e fortë, e qëndrueshme, me dashje e politikës me

krimin. Provat i kemi: kemi pasur edhe këtu deputetë me rekorde kriminale, kryebashkiakë me rekorde kriminale dhe administratë të lidhur me krimin. Miratuam ligjin për dekriminalizimin. Atëherë, nëse duam t'i bëjmë një shërbim të madh qoftë flamurit të BE-së, qoftë flamurit shqiptar, për të qenë dinjitoz dhe të valvitet nga puhiza europiane, do të duhet të ndërmarrim akte të tilla civilizuese europiane.

Qëndron në sirtarët e këtij parlamenti prej një viti vetingu politik. Është shumë e thjeshtë! Nuk po e them si sfidë politike ndaj ndokujt, jo, është si një nevojë e domosdoshme, imediate, ulëritëse. Nuk kemi rrugë tjetër veçse ky parlament të shkojë drejt kësaj. Kjo do të ishte zgjidhja, në mënyrë që krimi të mos e sfidojë shtetin në mes të ditës, në mënyrë që oligarkia, që nuk do t'ia dijë fare, të mos ndërtojë kate shtesë pa leje, në mënyrë që t'i japim dinjitet atij flamuri, se është detyrimi i secilit. Edhe një herë, mos e merrni si sfidë; nuk është sfidë personale, është detyrim, nevojë, është proporcionale, është sipas standardeve dhe, meqë tashmë jemi në një stinë të re europiane, ky është detyrim që ju qëndron të gjithëve.

E fundit, meqë jemi në një periudhë të tillë, ku duket se ka edhe sinjale për të bërë një purifikim të politikës 32-vjeçare për lidhjet e vjetra me komunizmin, i njëjti standard moral dhe logjik është edhe ky. Të përfitojmë të gjithë nga ky moment, t'ia japim Shqipërisë e, mbi të gjitha, flamurit këtë lloj dinjiteti. E kemi në dorë dhe e kemi tani. Faleminderit!